

21738

12

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. 21738 Akt.

V E N D I M

"Per regjistrimin si person juridik"

Ne Tirane sot me daten 29/04/1999 une gjyqtare e gjykates se Rrethit Tirane Anula Logo, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesit Kujtim Baholli i biri i Remziut, dtl.1967 dhe Merita Baholli (Gjoka)e bija e Remziut, dtl.1965, lindur dhe banues ne Tirane Rruga "Sh. Ishmi" Pll.44. sgj.3 ap.35, per regjistrim si person juridik

Nga materialet e paraqitura nga kerkuesit;

KONSTATOVA:

Ne baze te dokumenteve te paraqitura del se kerkuesit Kujtim dhe Merita Baholli kerkojne te krijojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "DAJTI KONSTRUKSION" S.R.L.

Ne baze te statutit te paraqitur, objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie do te jete :

Veprimtari ekonomike: Import aksesoresh dhe elemente per prodhime metalike si dollape, arshiva, rafte ,tavolina, karrike, ke...etj; tregtimin e mallrave te cdo lloji me pakice e shumice ,perpunimin dhe tregtimin e lendeve drusore dhe nenprodukteve te tyre, prodhimin dhe perpunimin e lendeve bimore, blektorale e ushqimore; prodhime artistike.

Si ortak te kesaj shoqerie jane Kujtim Baholli dhe Merita Baholli (Gjoka).

Administratore te shoqerise do te jene Kujtim Baholli dhe Merita Baholli (Gjoka).

Kapitali fillestar do te jete 100 000 leke.

Kohezgjatja e kesaj shoqerie eshte 10 vjet.

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane, ne adrese" Rruga "Sh. Ishmi" Pll.44. Shk.3, Ap.35.

Megenesse kerkesa e kerkuesve eshte ne perputhje te plote me kerkesat e ligjes ajo duhet pranuar;

PER KETON ARSYE

Ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe ne baze te ligjit nr.7667 date 28.01.1993. "Per rregjistrimin ne regjistrin Tregtar" neni 33.

V E N D O S A :

Rregjistrimin e shoqerise "DAJTI KONSTRUKSION" SH.P.K. me ortak te saj Z.Kujtim Baholli dhe Zj.Merita Baholli (Gjoka) si person juridik.

Selia e shoqerise do te jete Tirane, ne adrese:
Rruga "Sh.Ishmi" Pll.44, shk.3, ap.35.

Kapitali baze i kesaj shoqerie do te jete 100 000 leke.

Kohezgjatja e kesaj shoqerie eshte 10 vjet.

Administratore te saj jane :Kujtim Baholli dhe Merita Baholli (Gjoka).

Shoqeria "DAJTI KONSTRUKSION " SH.P.K. do te kete si objekt te veprimtarise se saj :

Veprimtari ekonomike: Import aksesoresh dhe elemente per prodhime metalike si dollape, arshiva,rafte ,tavolina, karrike, banake...etj; tregtimin e mallrave te cdo lloji me pakice e shumice ,perpunimin dhe tregtimin e lendeve drusore dhe nenprodukteve te tyre, prodhimin dhe perpunimin e lendeve bimore, blektorale e ushqimore; prodhime artistike .

Kunder ketij vendimi mund te behet proteste ose ankim ne Gjykatën e shkalles se dyte.

G J Y Q T A R I

Merita Baholli

gj

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. 21738/Vendimit

489

Tirane, me 14.10.99

**VENDIM
GJYQTARIT TE VETEM**

Sot dt. 14.10.1999 une Gjyqtare e Rrethit Tirane *Eniela Cofe* mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesit z. Kujtim Baholli dhe Merita Baholli (Gjoka), me cilesine e pronareve dhe administratoreve te shoqerise "DAJTI KONSTRUKSION" shpk. me qender ne Tirane, regjistruar ne Gjykate me vendimin nr 21738 date 29.09.1999 dhe

KONSTATOVA

Me vendimin nr.21738 date 29.09.1999 te Gjykates se rrethit Tirane eshte rregjistruar si person juridik shoqeria "DAJTI KONSTRUKSION" " sh.p.k me ortake e njekohesisht pronare z. Kujtim Baholli dhe Merita Baholli dhe administratore te dy ortaket z. Kujtim Baholli dhe Merita Baholli, me seli ne Tirane, me kapital fillestar 100000 leke Me vendimin nr 1 te ortakeve e administratoreve te shoqerise " DAJTI KONSTRUKSION" shpk z. Kujtim Baholli dhe Merita Baholli eshte vendosur ndryshimi i emrit te shoqerise nga "DAJTI KONSTRUKSION" shpk ne "DAJTI CONSTRUXION" shpk
Kerkuesit kerkojne qe ndryshimet e permendura te depozitohen prane regjistrin tregtar
Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar

**PER KETO ARSYE
NE BAZE TE LIGJIT 7667 dt. 28.01.1993**

VENDOSA

Pranimin e kerkeses per depozitim ne regjistrin tregtar te Vendimit nr 1 te ortakeve te shoqerise qe jane njekohesisht pronare e administratore te shoqerise "DAJTI KONSTRUKSION" shpk vetem te shoqerise z. Kujtim Baholli dhe Merita Baholli per ndryshimin e emrit te shoqerise nga "DAJTI KONSTRUKSION" shpk ne "DAJTI CONSTRUXION" shpk.

Te behen shenimet perkatese ne regjistrin tregtar

Gjyqtare

Eniela Cofe
Cf

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. 21.138/2 vendimi

V E N D I M
I GJYATQORIT TE VETEM

Sot me daten 19/12/2001, une gjyqtaria e gjykates se rrethit Tirane Altin Xhoxha si shqyrtova kerkesen dhe dokumentat e paraqitura nga Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuara "DAJTI CONSTRUXION" shpk Tirane, me ortak Kujtim Baholli dhe Merita Baholli (Gjoka) per depozitimin e dokumentave per ndryshime ne statutin e shoqerise,

V E R E N

Shoqeria me pergjegjesi te Kufizuara "DAJTI CONSTRUXION" shpk Tirane, eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr. 21738 date 29.09.1999 te Gjykates se Rrethit Tirane, per te ushtruar veprimtari private te percaktuar me hollesisht ne vendimin e saj.

Me vendimin te dates 27.11.2001 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise eshte vendosur si me poshte:

Te largohet nga shoqeria ortakia Merita Baholli (Gjoka).

Ortakia Merita Baholli (Gjoka) e cila merrte pjese ne kapitalin themeletar ne masen 50% , me vlere nominale 50.000 (Pesdhjetemije) leke ja shet ortakut tjeter kete kuote ne masen 50% me vlere nominale 50.000 (Pesdhjetemije) leke Z. Kujtim Baholli kundrej vleftes 50.000 Leke.

Me kontraten e shitjes me nr. 9366 rep.2197 kol, date 14.12.2001 ortakia Merita Baholli (Gjoka) i ka shitur ortakut tjeter Z. Kujtim Baholli ,kuoten e saj te kapitalit themeltar prej 50% me vlere nominale 50.000 Leke, kundrejt vleftes prej 50.000 leke.

Perfundimisht ortak i vetem i shoqerise "DAJTI CONTRUXION" mbetet z. Kujtim Baholli, me 100% te kapitalit.

Nga dokumentet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj dhe si e tille te pranohet.

PER KETO ARSYE


Ne mbeshtetje te ligjit nr.7667 date 28 jana 1993

V E N D O S A

1. Pranimin e kerkeses

2. Depozitimin e kerkeses dhe dokumentave te paraqitura nga shoqeria "DAJTI CONSTRUXION" shpk Tirane duke u bere shenimet perkatese ne fleten e regjistrimit ne kollonen 3, kollona 4/c e kollona 5, te ndahen regjistrimet nga njeri tjeteri me vije te kuqe.

GJYQTARE

Altin Xhoxha


V E N D I M
I GJYQTARIT TË VETËM

Në Tiranë, sot më datën 15-05-2007, unë J. Hoxha, gjyqtare e Gjykatës së rrethit gjyqesor Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën dhe materialet e paraqitura nga kërkuesi KUJTIM BAHOLLI, në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë, i cili kërkoi depozitimin e vendimit Nr. 3 datë 02/05/2007 të ortakut te vetem te "DAJTI CONSTRUXION" SHPK

KONSTATOVA SE

Me vendim nr. 21.738, date 29.07.1999, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, shpk "Dajti Construxion" është regjistruar si person juridik me seli në Tirane, për të ushtruar aktivitetin e vet privat sipas objektit të veprimtarisë së vendosur në statutin e shoqërisë.

Me vendimin Nr. 3 datë 02.5.2007, te ortakut te vetem eshte vendosur:

1. ndryshimi I selise se shoqerise nga adresa egzistuese miratuar me vendim te Gjykates rrethit Tirane, ne adresen e re, rruga e "Kavajes", (ish fabrika e leter kartonit) Tirane

Kërkesa e paraqitur është e bazuar ne ligj dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARËSYE:

Në bazë të Ligjit 7638 dt. 19. 11. 1992 dhe 7667 dt. 28. 01. 1993.

VENDOSA

I. Pranimin e kërkesës.

II. Depozitimin e Vendimit Nr. 3, datë 02/05/2007, të Ortakut te vetem të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Dajti Construxion" Sh.p.k, ku eshte vendosur:

2. 1. ndryshimi I selise se shoqerise nga adresa egzistuese miratuar me vendim te Gjykates rrethit Tirane, ne adresen e re, rruga e "Kavajes", (ish fabrika e leter kartonit) Tirane

III. Urdhërimin e Zyrës së Regjistrimit për bërjen e ndryshimeve përkatëse në dokumentat e shoqërisë.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim.

GJYQTARE

J. Hoxha
15/05/07

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
Nr. 21738/5Vendimi

VENDIM
I GJYQTARES SE VETME

Sot me dt // /07/2007 une Gjyqtare Elbana Lluri e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga administrator i shoqerise Z.Kujtim Baholli per depozitimin e vendimit nr.5 dt.10.07.2007 te ortakut te vetem te shoqerise " **DAJTI CONSTRUXION** " shpk dhe :

KONSTATOVA

Me vendimin nr. 21738 date 29.07.1999 të Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, eshte regjistruar shoqeria tregtare "**DAJTI CONSTRUXION** " shpk me seli ne Tirane Rr «Sh.Ishmi » pall.44 shk.3 ap.35 me kapital themeltar te shoqerise 100.000 leke e kohezgjatje 10 vjet me ortak e administrator Z.Kujtim Baholli.

Me vendimin nr.5 dt.10.07.2007 te ortakut te vetem te shoqerise eshte vendosur :
-Miratimi I raportit te paraqitur nga ekspertja kontabel e autorizuar Znj.Violeta Holoçi me nr.83 liç dt.10.01.2001 per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise "**DAJTI CONSTRUXION** " shpk nepermjet rikapitalizimit te fitimit te akumuluar dhe te pashperndare nga ana e shoqerise gjendje te dates 31.12.2006.

-Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise "**DAJTI CONSTRUXION** " shpk sipas menyres se percaktuar ne raportin e ekspertit kontabel te autorizuar.

-Zmadhimi I kapitalit themeltar te shoqerise "**DAJTI CONSTRUXION** " shpk nga 100.000 leke ne 12.100.000 leke.

-Vlera nominale e e nje kuote te kapitalit pas rritjes se kapitalit behet nga 1.000 leke ne 12.000 leke.

-Depozitimin e ketij vendimi prane Zyres se Regjistrir Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit Nr.7512 dt.10.08.1991, ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992, ligjit Nr.7667 dt.28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar":

V E N D O S A

-Pranimin e kerkeses.

-Depozitimin prane Rregjistrir Tregtar te Vendimit nr.5 dt.10.07.2007 te ortakut te vetem te shoqerise " **DAJTI CONSTRUXION** " Sh.p.k Z.Kujtim Baholli.

-Urdherohet Zyra e Regjistrir Tregtar të beje ndryshimet ne kollonat perkatese duke i ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije të kuqe.

-Urdherohet Zyra e Rregjistrir Tregtar te njoftoj personat financiar te interesuar.

-Kunder vendimit lejohet ankim.

GJYQTARE
Elbana LLURI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
Nr. 21738/4Vendimi

VENDIM
I GJYQTARES SE VETME

Sot me dt. ⁰⁹10/07/2007 une Gjyqtare Blerina Muça e Gjykeses se Rrethit Gjyqesor Tirane mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga administratori i shoqerise Z.Kujtim Baholli per depozitimin e vendimit nr.4 dt.20.06.2007 te ortakut te vetem te shoqerise " **DAJTI CONSTRUXION** " shpk dhe :

KONSTATOVA

Me vendimin nr. 21738 date 29.07.1999 të Gjykeses se Shkalles se Pare Tirane, eshte regjistruar shoqeria tregtare " **DAJTI CONSTRUXION** " shpk me seli ne Tirane Rr «Sh.Ishmi» pall.44 shk.3 ap.35 me kapital themeltar te shoqerise 100.000 leke e kohezgjatje 10 vjet me ortak e administrator Z.Kujtim Baholli dhe Znj.Merita Baholli.Mbas shume ndryshimesh ortak e administrator mbetet Z.Kujtim Baholli dhe ndryshim adrese tek Rr « Kavajes » ish fabrika e letres kartonit Tirane.

Me Vendimin nr.4 dt.20.06.2007 ortaku i vetem i shoqerise ka vendosur:
-Fillimin e procedures per zmadhimin e kapitalit te shoqerise " **DAJTI CONSTRUXION** " shpk, nepermjet rikapitalizimit te fitimit te akumuluar dhe te pashperndare nga ana e shoqerise gjendje e dt.31.12.2006.
-Te caktoje Znj.Violeta Haloçi anetare e IKEA me profesion Eksperte Kontabel e Autorizuar, mbajtese e licences me nr.83 dt.10.01.2001 per kryerjen e aktit te ekspertimit.

Ne keto kushte kerkoj depozitimin e ketyre ndyshimeve prane rregjistrimit tregtar.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.


PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr.7512 dt.10.08.1991, ligjit nr.7638 dt.19.11.1992 ligjit nr.7667 dt.28.01.1993 " Per regjistrim tregtar".

VENDOSA

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitimin e vendimit nr.4 dt.20.06.2007 te ortakut te vetem te shoqerise " **DAJTI CONSTRUXION** " shpk te Z.Kujtim Baholli.
- Urdherohet Zyra e Regjistrimit Tregtar të beje ndryshimet ne kollonat perkatese duke i ndare regjistrimet nga njeri - tjetri me vije të kuqe.
- Urdherohet Zyra e Rregjistrimit Tregtar te njoftoj personat financiar te interesuar.
- Kunder vendimit lejohet ankim.

GJYQTARE
Blerina MUÇA



K O N T R A T

Per krijimin e shoqerise "DAJTI KONSTRUKSION" SH.P.K.



Sot me daten 22/1/1999, ditën e _____ Ortaket e kesaj shoqerie themeluan shoqerine "DAJTI KONSTRUKSION" shpk me kushtet si me poshte:

Neni 1

Personat fizik te siperpermendur, me vullnetin e tyre te lire dhe ne pajtim me legjislacionin shqiptar, krijuan shoqerine me pergjegjesi te kufizuar (SH.P.K.) me emertimin "DAJTI KONSTRUKSION".

Kjo shoqeri e ka qendren ne qytetin e Tiranes ne adrese Rruga "Sh. Ishmi" Pll.44, shk.3, ap.35 "

Ortake te kesaj shoqerie jane Kujtim Baholli dhe Merita Baholli.

Administrator te kesaj shoqerie jane Kujtim Baholli dhe Merita Baholli.

Shoqeria ka te drejte te krijojë filiale te saj brenda dhe jashte vendit ne cdo kohe qe do te cmohet e aresyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

Neni 2

Shoqeria " DAJTI KONSTRUKSION" SH.P.K. gezon statusin e personit juridik. Veprimtaria e saj do te zhvillohet sipas dispozitave te kesaj kontrate, statutit te saj dhe legjislacionit ne fuqi. Statuti i shoqerise i bashkangjitet kesaj kontrate dhe eshte pjese perberese e saj.

Neni 3

Veprimtaria e shoqerise si person juridik fillon me aprovimin e krijimit te saj nga organet kompetente te shtetit dhe do te vazhdoje per nje periudhe kohe prej 10 vjetesh.


Shoqeria e mbaron aktivitetin e saj me kalimin e afatit te parashikuar ne kete kontrate, neqoftese themeluesit me vullnetin e tyre te lire nuk e zgjasin kete afat.



Neni 4

Shoqeria "DAJTI KONSTRUKSION" SH.P.K. do te kete si objekt:

Veprimtari ekonomike: Import aksesoresh dhe elemente per prodhime metalike si dollape, arshiva, rafte, tavolina, karrike, banake...etj; tregtimin e mallrave te cdo lloji me pakice e shumice, perpunimin dhe tregtimin e lendeve drusore dhe nenprodukteve te tyre, prodhimin dhe perpunimin e lendeve bimore, blektorale e ushqimore; prodhime artistike



Neni 5

Kapitali themeltar i kesaj shoqerie eshte 100 000 leke. Ne krijimin e ketij kapitali merrin pjese vetem themeluesit e kesaj shoqerie ne masen 50% me 50% sejcili.

Neni 6

Fitimi neto qe do te realizohet nga veprimtaria e kesaj shoqerie i perket ortakeve te kesaj shoqerie sipas kontributeve ne shoqeri.

Neni 7

Per detyrimet qe do krijohen ndaj personave te trete gjate aktivitetit te kesaj shoqerie, kjo shoqeri pergjigjet vetem me kapitalin e saj. Ortaket nuk mbajn pergjegjesi per detyrimet e shoqerise me pasurine e tyre qe nuk ben pjese ne kapitalin e kesaj shoqerie.

Neni 8

Marredheniet e punes ne shoqeri ose ne filialet e saj rregullohen nepermjet kontrates se punes.

Neni 9

Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj. Themeluesit e shoqerise si lexuan me vemendje kontraten e mesiperme dhe e gjeten konform vullnetit te tyre, e firmosen vullnetarisht kete kontrate.

ORTAKET

Kujtim Y. Bolishi
Bouy.

Merita Bolishi (Gjate)
U. Bolishi



S T A T U T I

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "DAJTI KONSTRUKSION"
SH.P.K

K R E U I

Dispozitat e Pergjithshme

N E N I 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "DAJTI KONSTRUKSION" SH.P.K, eshte krijuar sipas kontrates dhe ketij statuti te perpiluara dhe nenshkruara nga ortaket e saj :

1. Kujtim Baholli i biri i Remziut, dtl.1967, lindur dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.
2. Merita Baholli (Gjoka) e bija e Remziut, dtl.1965, lindur dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

N E N I 2

Emertimi i shoqerise eshte "DAJTI KONSTRUKSION" SH.P.K.

N E N I 3

Shoqeria e percaktuar ne nenin 1 te ketij statuti krijohet me mjetet ne pronesi private te themeluesve te saj.

N E N I 4

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "DAJTI KONSTRUKSION" SH.P.K ne perputhje me vendimin per krijimin e kesaj shoqerie dhe me legjislacionin shqiptar, regullon poziten juridike te themeluesve dhe punonjesve ne shoqeri, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise.

N E N I 5

Shoqeria "DAJTI KONSTRUKSION" SH.P.K eshte person juridik shqiptar dhe fiton personalitet juridik qe nga data e regjistrimit ne organet perkatese.

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentet e krijimit te saj, kontraten dhe ne kete statut.

N E N I 6

Selia e shoqerise "DAJTI KONSTRUKSION" SH.P.K. eshte ne Tirane, ne adrese: Rruga "Sh. Ishmi". Pll.44, shk.3, ap.35.



-2-

N E N I 7

Administrator te kesaj shoqerie jane: Kujtim Baholli dhe Merita Baholli (Gjoka).

N E N I 8

Shoqeria ka vulen e saj ne forme katerkendeshi me madhesi te zakonshme shkruar Shoqeria Private "DAJTI KONSTRUKSION" SH.P.K.

N E N I 9

Shoqeria ka per objekt :
Veprimtari ekonomike: Import aksesoresh dhe elemente per prodhime metalike si dollape, arshiva, rafte ,tavolina, karrike, banake...etj; tregtimin e mallrave te cdo lloji me pakice e shumice ,perpunimin dhe tregtimin e lendeve drusore dhe nenprodukteve te tyre, prodhimin dhe perpunimin e lendeve bimore, blektorale e ushqimore; prodhime artistike

N E N I 10

Shoqeria ushtron veprimtarine e vet te percaktuar ne kete statut ne teritorin e Republikes se Shqiperise. Per kryerjen e kesaj veprimtarie shoqeria mund te cele dege, zyra dhe filiale -- saj te perfaqesimit brenda vendit dhe jashte tij ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe te vendit ku eshte hapur.

N E N I 11

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e cilesive te larta te punes, te sigurise dhe te rentabilitetit.

N E N I 12

Pjesemarrja ne shoqeri nuk i pengon ortaket te kene pavaresi ligjore per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie. Ata nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise qe rrjedhin nga objekti i veprimtarise se saj tej kapitalit themelor ku ata kane marre pjese.

N E N I 13

Ortaket kane keto te drejta kryesore:
- Te marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me kontraten dhe statutin, vete ose nepermjet perfaqesuesve te tij.



-3-

- Te marrin pjese ne rezultatet e veprimtarise se shoqerise ne cdo forme dhe sasi qofte, ne perputhje me statutin dhe kontraten.

- Te marrin pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen nepermjet perfaqesuesve te tyre ose vete.

- Te kerkojne t'u jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen prodhuese dhe tregtare te shoqerise, si dhe te gjitha dokumentat e perpunuara te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj.

- Te bejne propozime dhe t'i paraqesin ato per shqyrtim para organeve te shoqerise.

- Te emerojne dhe te shkarkojne perfaqesuesit e saj, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuidatoret.

- Te heqin dore nga shoqeria.

Heqja dore nga shoqeria nuk i liron ortakët nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise.

N E N I 14

Ortakët kane keto detyra kryesore:

- Te marrin pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara prej tyre, vete ose nepermjet perfaqesuesve qe caktojn ata.

- Ti japin shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj.

- Te kryejne sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.

K R E U II KUSHTET EKONOMIKE

N E N I 15

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te veprimtarise kontabel dhe pasqyrohet ne bilancin e saj.

N E N I 16

Per te bere te mundur zhvillimin e shoqerise caktohet nje kapital themeltar prej 100.000 leke.

N E N I 17

Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet shtimit te pjeseve te saj ortakët kane te drejten e rritjes se tije ne menyre proporcionale.

N E N I 18

Pjesët e kapitalit themeltar jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie ne rast ndarje pasurie ndermjet bashkeshorteve dhe nepermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

Beqir

Beqir



-4-

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohet me akt noterial.

N E N I 19

Shoqeria ne emer te vet eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj, por gjithmone ne perputhje me qellimin e objektin e veprimtarise qe ajo kryen.

Shoqeria mund te shese pasuri ose te shfrytetoje te drejta te tjera materiale. Ajo mund te ofroje per garanci edhe pasuri te saj per te marre kredi bankare.

N E N I 20

Shoqeria krijon fonde rezerve ose dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin dhe nxitjen ekonomike te saj.

Shoqeria disponon mjetet e veta financiare. Detyrimet eventuale qe mund te lindin gjate veprimtarise se saj mbulohen nga fonde rezerve, nga fondet e tjera ose nga shumat suplementare qe kur deshirojne mund te derdhen prej ortakeve, ne rastet kur keto detyrime nuk mund te mbulohen nga fondet ekzistuese.

K R E U III
VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMIT

N E N I 21

Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht viti i pare financiar ka fillim me ditene e regjistrimit te firmes dhe ka perfunduar me 31 dhjetor te vitit 1999.

N E N I 22

Llogarite vjetore inventari, raportet operacionet e veprimtarise se vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga asamblea. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

N E N I 23

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria, mbasi zbriten te gjitha detyrimet si edhe fondet e lena rezerve per nxitjen ekonomike, per investime, per reklamen tregtare etj. perfitohen prej ortakeve themelues te kesaj shoqerie.

B. Bani

B. Bani



-5-

N E N I 24

Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 Marsit te vitit pasardhes.

K R E U IV
ADMINISTRIMIN E N I 25

Ortaket e shoqerise i perballojn humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se tyre te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar.

N E N I 26

Organi vendimor i shoqerise eshte Asambleja e ortakeve. Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga administratoret, nga eksperti kontabel i autorizuar ose nga likuiduesit.

N E N I 27

Sipas rendesise se vendimeve mbledhja e Asamblese mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme. Asambleja e zakonshme vendos per ceshtje te tilla si emerim ose shkarkim i ekspertit kontabel te autorizuar dhe likuiduesve, miratimin e raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimin e llogarive vjetore, te ndarjes se fitimit. Asambleja e jashtezakonshme vendos per ceshtje te tilla si ndryshimin e statutit, zvogelimin e pjeseve te kapitalit themeltar, zmadhimin e kapitalit themeltar, transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar, shnderrimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne forma te tjera, mbylljen e shoqerise para kohe.

N E N I 28

Administrimi i shoqerise behet nga administratoret. Ne shoqerine "DAJTI KONSTRUKSION" SH.P.K administrator jane Kujtim Baholli dhe Merita Baholli te cilet ne te njejten kohe kane edhe funksionin e perfaqesimit te shoqerise me te tretet ne gjithë veprimtarine e saj. Me miratimin e ortakeve mund te emrohen administrator dhe perfaqesues te shoqerise "DAJTI KONSTRUKSION" shpk.

N E N I 29

Administratoret emerohen per nje kohezgjatje prej tre vjetesh financiare me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem. Administratoret kane te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet me interes



-6-

te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh. Administratoret jane pergjegjes individualisht ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faj te tyre gjate administrimit te shoqerise.

N E N I 30

Kopetencat e administratorve ne shoqeri jane:

- Te miratojne planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre ne kuadrin e veprimtarise se shoqerise.
- Te bejne propozimet e nevojshme ne mbledhjen e asambles kur lind nevoja e kapitalit themeltar te shoqerise.
- Te miratojne akte normative qe percaktojne raportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin dhe personelin.
- Te percaktojne strukturen e aparatit te shoqerise.
- Te krijojne organe te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te shoqerise.
- Te propozojne ne mbledhjen e asambles per krijimin e njesive, srukturave si filiale, dege e perfaqesi ne qytete te tjera te vendit apo jashte shtetit.
- Te pergatisin propozimet per pushimin e veprimtarise se shoqerise dhe t'ia paraqesin ato Asamblese per miratim.
- Te perzgjedhin ekspertet kontabel dhe anetaret e komisionit te likuidimit dhe te paraqesin propozimet per miratim ne asamble.
- Te sigurojne zbatimin e perpikete te vendimeve te asamblese.
- Te percaktojne numrin e punonjesve te shoqerise dhe pagat e tyre.

N E N I 31

Kontrolli i shoqerise mund te kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar per tre vite financiare me mundesi rizgjedhjeje. Ai caktohet nga administratoret e shoqerise. Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kondita si emerimi, ose kur behet e pamundur kryerja e detyres.

K R E U V KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

N E N I 32

Afati i veprimtarise se shoqerise caktohet deri ne vitin 2009 duke filluar nga viti 1999, si vit i pare i veprimtarise.

-7-

K R E U VI
MARREDHENIET E PUNES

N E N I 33

Marreveshja e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqerise, legjislacionit shqiptar dhe me kete statut.

N E N I 34

Punesimi i punonjesve ne shoqeri behet mbi bazen e kontrates kolektive dhe individuale te punes.

Ne kontraten e punes rregullohen keto ceshtje:

- Kushtet dhe menyra e marredhenies se punes.
- Fillimi i punes se punonjesve dhe caktimi i tij ne vendin e punes.
- Koha e punes dhe caktimi i kohes se punes, puna e nates, puna jashte kohes normale, puna ne ditet e pushimit javor, festave zyrtare.
- Mbrojtja ne pune dhe kushtet e punes.
- Pushimet dhe mungesat, te drejtat, detyrimet dhe pergjegjesite e punonjesve per zbatimin e detyrave te punes.
- Pushimi i marredhenies se punes.
- Paga e punes se punonjesit, shperblimi i punes dhe shperblime te tjera.

N E N I 35

Shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve prane saj ne organet perkatese duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet e caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

N E N I 36

Per te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte gjykata e rrethit Tirane.

K R E U VII
MBYLLJA E SHOQERISE

N E N I 37

Veprimtaria e shoqerise mbaron ne afatin e percaktuar ne aktin e themelimit (kontrate dhe statutin). Veprimtaria e shoqerise mund te mbyllet edhe kur gjate dy vjeteve te njepasnjeshem veprimtaria e shoqerise nuk rezulton rentabel ose kur ortaket heqin dore nga shoqeria.

KB

Bolell



-8-

N E N I 38

Kur shoqeria likuidohet asambleja mbledh komisionin e likuidimit i cili paraqet per miratim bilancin e likuidimit te shoqerise.

Shoqeria i jep fund veprimtarise ne castin e miratimit te bilancit te likuidimit.

N E N I 39

Mjetet financiare si dhe cdo pronesi tjeter e fituar si rezultat i veprimtarise se shoqerise kur shoqeria likuidohet, i takojne ortakëve te saj pasi te jene zbritur dhe bere pagesat per te gjithë kreditorët e shoqerise.

K R E U VIIIDISPOZITAT E FUNDITN E N I 40

Te gjitha vendimet e shoqerise regjistrohen ne nje liber te vecante qe mbahen ne seline e shoqerise.

N E N I 41

Ky statut eshte hartuar sot me date __/__/1999 per shoqerine "DAJTI KONSTRUKSION" SH.P.K.

O R T A K E T

Kujtim Bahelli
K. Bani

2. Arita Bahelli (gjate)
A. Bahelli

21738

Z. A. Cepo
26. 7. 1992 fl.



- Kerkuësit:
1. Kujtim Baholli i biri i Remziut, dtl. 1967, lindur dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.
 2. Merita Baholli (gjoka) e bija e Remziut, dtl. 1965, lindur dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

Objekti: Rregjistrimi si person juridik i shoqerise me pergjegjesi te kufizuara te emertuar "DJATI KONSTRUKSION", me seli ne Tirane, ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 "per Shoqerite Tregtare" dhe ligjit 7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrimin ne Regjistrin tregtar".

PERPARA GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

Kerkuesit Kujtim dhe Merita Baholli (Gjoka), paraqesin prane Gjykates se Rrethit Tirane kerkesen e tyre per te rregjistruar si person juridik shoqerine " DAJTI KONSTRUKSION " SH.P.K.

Kjo shoqeri e ka seline e saj ne Tirane ne Adrese: Rruga "Sh. Ishmi", Pallati 44, shk. 3, ap. 35.

Kujtim Baholli dhe Merita Baholli (Gjoka) jane Administrator dhe ortak te kesaj shoqerie.

Kapitali fillestar i kesaj shoqerie do te jete 100 000 leke.

Kohezgjatja e kesaj shoqerie do te jete 10 vjet.

Objekti i veprimtarise ekonomike te kesaj shoqerie do te jete:

Veprimtari ekonomike: Import aksesoresh dhe elemente per prodhime metalike si dollape, arshiva, rafte, tavolina, karrike, banake...etj; tregtimin e mallave te cdo lloji me pakice e shumice, perpunimin dhe tregtimin e lendeve drusore dhe nenprodukteve te tyre, prodhimin dhe perpunimin e lendeve bimore, blektorale e ushqimore; prodhime artistike

Megenese kjo shoqeri eshte krijuar ne konformitet te plote me ligjin, kerkojme regjistrimin e saj si person juridik prane gjykates se rrethit Tirane.

K E R K U E S I T

Kujtim Baholli
[Signature]

2. Merita Baholli (Gjoka)
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr. 10 Rep.

V E R T E T I M

Sot me daten 22.7.1999 ne zyren e Noterise Tirane,
perpara meje Noteres Mimoza Shehu u paraqiten themeluesit e
shoqerise "DAJTI KONSTRUKSION" shpk te cilet pas legalizimit te
dokumentave te kesaj shgoqerise depozituan ne kete zyre kapitalin
themeltar te saj ne shumen 100.000 (Njeqindmije) leke.



NOTE R E
MIMOZA SHEHU
NR. TEL: ZYRE
TEL: 271-2501 199

Mimoza Shehu 021

21738/1
189

KERKESE

KERKUES: Kujtim Baholli dhe Merita Baholli (Gjoka) te bijte e Remziut, me banim ne Tirane, pronar dhe administrator te shoqerise "DAJTI CONTRUXION" shpk me qender ne Tirane, regjistruar ne Gjykate me Vendimin nr.21738 date 29.09.1999;

me:
OBJEKT: Ndryshimin e emertimit te shoqerise "DAJTI KONSTRUKSION" ne "DAJTI CONSTRUXION" shpk.

PERPARA: GJYKATES SE RRETHIT
T I R A N E

Jemi pronar dhe ortak te shoqerise "DAJTI KONSTRUKSION me seli ne Tirane ne adrese Rruga "Sh. Ishmi" Pll.44, shk.3 ap.35 regjistruar ne Gjykate me vendimin nr. 21738 date 29.09.1999

